


Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës
01Nr. 20/01-18478/2.1
Kaçanik, 05.07.2021

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR PËRCJELLEN E FUSHATËS SË KORRJE-SHIRJEVE PËR VITIN 2021 NË KOMUNËN E KAÇANIKUT

I

Me këtë vendim formohet komisioni Komunal për përcjellje të fushatës së korrje – shirjeve për vitin 2021, në territorin e Komunës së Kaçanikut me këtë përbërje:

- 1.Zylfi Koxha, Kordinator i sektorit të bujqësisë
- 2.Bujar Bajra, Zyrtar për emergjencë
- 3.Mustafë Loku, zyrtar për Bujqësi dhe Blegtori

II

Komisioni i formuar është i obliguar që ti bëjë përcjelljen e vazhdueshme të fushatës së korrje-shirjeve dhe pas përfundimit të fushatës duhet të hartoj raport me shkrim me të cilin do të njoftoj: Kryetarin e Komunës, MBPZHR-së dhe DBZHRP-së.

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

IV

Me këtë Vendim njoftohen : Arkivi i Komunës, DBZHRP-së dhe anëtarët e komisionit.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF
KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik
Zyra e Kryetarit



01.Nr 104/02-21343/21
Kaçanik, 26.07.2021

Në mbështetje të nenit 17 pika h dhe pika r, nenit 58 pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 9 të Rregullores për Përcaktimin e Kritereve për Ndarjen e Subvencionëve dhe Transfereve si dhe në bazë të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM
PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

1. LEJOHET ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në shumë prej 3.000.00 euro për vitin 2021.
2. U lejohet shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 3.000.00 euro SHKA “Tingujt e Vendlindjes” Stagovë.
3. Mjetet Buxhetore nga ky vendim sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.
4. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës si dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
6. Vendimi i dërgohet Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, SHKA “Tingujt e Vendlindjes” Stagovë si dhe arkivit komunal.

Kryetari i Komunës

z. Besim Hazi



Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. "Qamil Ilazi" Nr. 28, 71000 Kaçanik; Tel. 038 200-46401;



01Nr350/04-21137-1/21
30.07.2021

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në bazë të Vendimit 01Nr.350/04-21137/21 të Kryetarit të Komunës dhe në bazë të Ligjit për Ndërtim 04/L-110, Kryetari i komunës merr këtë:

VENDIM

1. Për emërimin e anëtarëve të komisionit, konform Vendimit 01Nr.350/04-21137/21 me përbërje prej pesë (5) antarëve-zyrtarë komunal:
 - 1.1. Betim Shala-inxhinier i ndërtimit, zyrtar në DUKMM
 - 1.2. Ilir Koraqi,inxhinier i ndërtimit, zyrtar në DSHPE
 - 1.3. Valmir Krasniqi,inxhinier i arkitekturës, zyrtar në DSHPE
 - 1.4. Zekir Selimi, jurist, zyrtar në DUKMM
 - 1.5. Arian Teneqja, inxhinier i ndërtimit, zyrtar në DSHPE
2. Anëtarët e komisionit duhet të shqyrtojnë të gjitha kërkesat në të cilat do të kompenzohet pjesa e parcelës (parcelave) me sipërfaqe ndërtimore.
3. Komisioni duhet të zbatojë në përpikmëri Vendimin 01Nr.350/04-21137/21 të datës 23.07.2021.
4. Komisioni do të përpilojë procesverbal për çdo kërkesë të shqyrtuar me të cilin njoftohet zyra e kryetarit.
5. Mandati i komisionit do të jetë tre (3) vite.
6. Ky vendim bëhet i plotfuqishem me rastin e nënshkrimit të tij.

Vendimi u dërgohet:

1. Kryetarit të Komunës,DUKMM
2. Anëtarëve të Komisionit, dhe
3. Arkivit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi





I	Data <u>23.07.2021</u>	Vendi <u>KAÇANIK</u>
Nj. org.	Numri	Shtojcë
<u>01</u>	<u>309/06-21137</u>	<u>/</u>

Kaçanik
23.07.2021

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2.3, dhe nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit NR. 05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 13 dhe nenit 58 shkronja g) të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 6 shkronja e) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, në bazë të UA MMPH nr 08/2017 për Normat Tenike të Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës nxjerrë këtë:

VENDIM

I. Një nga mënyrat e kompensimit të tokës private të planifikuar për interes të përgjithshëm, duke u bazuar në Vendime e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Zhvillimor Komunal të jetë aplikimi i kushteve të ndërtimit edhe për sipërfaqen e kësaj toke.

II.1. Kompensimi me sipërfaqe ndërtimore sipas formës nga pika I e këtij vendimi për sipërfaqen e ngastrës së shpronësuar që planifikohet për interes të përgjithshëm, nuk mund të jetë më i madh se 20% (e sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore).

2. Aplikimi i kompenzimit me sipërfaqe ndërtimore nga al,1 e pikës II të këtij vendimi, do të bëhet në proporcione përqindjen e tokës së planifikuar për interes të përgjithshëm ndaj parcelës kadastrale apo bllokut ndërtimor të formuar me bashkimin e mexheve sipas bazës juridike valide.

3. Përjashtimisht nga pika II e këtij vendimi, nëse pronari apo investitori i autorizuar i pronarit pajtohet, kjo formë kompensimit mund të aplikohet edhe nëse përqindja e tokës që është objekt kompensimi tejkalon maksimumin e përqindjes (20%) së paraparë për rritje të sipërfaqes ndërtimore nga al,1 të pikë II të këtij vendimi por pa ndikim në rritje të sipërfaqes ndërtimore apo obligim tjetër të komunës për kompensim.

III. Rritja e sipërfaqes ndërtimore sipas këtij vendimi, nuk do të aplikohet në indeksin e shfrytëzimit të parcelës së planifikuar për ndërtim sipas Planeve apo ligjeve në fuqi, por i njëjtë do të aplikohet vetëm në rritjen e indeksit të ndërtimit (në etazhitet).

IV.Format e kompensimit të tokës sipas këtij vendimi do të aplikohet vetëm në bazë të marrëveshjes me pronarin e tokës apo me të autorizuarin ligjor të pronarit.

- a) Pëlqimi paraprak në mes të komunës dhe pronarit apo të autorizuarit të tij për formën e kompensimit sipas këtij vendimi, do të arrihet përmes procedurës së caktimit të Kushteve Ndërtimore, të lëshuar në organi kompetent për punë të urbanizmit.
- b) Nëse kemi dallim të koeficienteve sipas zonave të caktuara me koeficient të ndërtimit, atëherë do të merret për bazë koeficienti më i madh në infrastrukturën e planifikuar për llogaritje (p.sh. nëse kemi dy zona të banimit afër njëra tjetrës ZB5 dhe ZB6 atëhere merret koeficienti ZB6, që është më i madh në tërë hapsirën).
- c) Në rast të mospërputhjes së trasës së rrugës së planifikuar dhe asaj ekzituese, dhe në rastet kur rruga e planifikuar e pamundëson zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të bllokut të planifikuar për të ofruar mundësi të barabart të zhvillimit për të gjithë qytetaret, dhe për të siguruar vazhdimësinë e zhvillimit të ndërtimeve të reja në harmoni me të gjitha kriteret të planikuara me Planet në fuqi të veprohet forma e aplikimit sipas nenit 6 dhe 1 UA06/20217 MMPH.
- d) Marrëveshjet definitive, hapat dhe format për të arritur deri tek marrëveshjet për formën e kompensimit sipas këtij vendimi, do të nënshkruhen në DUKMM, të cila marrëveshje do të ketë fuqi juridike, ekzekutive dhe të cila do të shërbejn si bazë juridike për ndryshimet në aparatin kadastral.
- e) Veprimet juridike nga al.3 e pikës IV ,të këtij vendimi ,do të kryhen në procedurën për paisje me leje ndërtimore.

V.1 Kryetari i Komunës do të formojë një komision, i cili do të shqyrtojë sipërfaqen e paluatshmërisë-ve (për këmbim) nga komuna e Kaçanikut si dhe do të caktojë sipërfaqen ndërtimore e cila i takon si kompenzim pronarit-ve të tokës.

2.Komisioni do t'i raportojë kryetarit të komunës në afat prej 5 ditësh nga marrja e njoftimit.Zbatimi i këtij vendimi do të bëhet përmes drejtorisë së Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të komunës së Kaçanikut.

VI. Forma e kompenzimit:

-Shfrytëzimi maksimal i sipërfaqes së pronës të jetë 65%

-Llogaritja e sipërfaqes ndërtimore si kompenzim:

Do të llogaritet sipërfaqja ndërtimore e lejuar (duke shfrytëzuar 65% parcelën), për të gjithë parcelën (duke përfshirë edhe pjesën që do të shpronësohet). Sipërfaqja qo të dalë nga kjo llogaritje, do të jetë sipërfaqja e lejuar për leje ndërtimi. Pjesa e mbetur e

parcelës kadastrale do të shfrytëzohet 65%, kurse pjesa e mbetur e sipërfaqes ndërtimore do të shtohet si etazha sipër etazhave të lejuara.

-Suterreni do të llogarite 50% në sipërfaqe shtesë.

-Bodrumi nuk do të llogaritet në sipërfaqen shtesë.

Në shtojcën e këtij vendimi keni një shembull të llogaritjes.

VII.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga kryetarit i komunës të Kaçanikut.

Arsyetim

Në miratimin e Planeve Hapësinore të Kaçanikut, në miratimin e Vendimeve të Kuvendit të Kaçanikut janë planifikuara sipërfaqe të konsiderueshme të pronave private për nevojat e interesit të përgjithshëm, kryesisht të destinuara për nevojat e ndërtimit të rrugëve publike të kategorizuara si rrugë urbane.

Realizimi i përbajtjeve të planifikuara me këto plane (ndërtimi i këtyre rrugëve) në mungesë të mjeteve financiare dhe në mungesë të planifikimit të pozicionit buxhetor për kompensim e këtyre pronave, shumica e tyre nuk kanë mundur të vihen në prioritet për ndërtim.

Gjatë analizave për zgjedhjen e kësaj çështje, është ardhur në përfundim se një ndër format e mundshme për kompensimin e këtyre pronave private do të ishte edhe barazimi me investitorët përmes kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore.

Duke shqyrtauar këto kërkesa është përfunduar se kjo mundësi e kompensimit do të mund të aplikohet në kushte që maksimumi i rritjes së koeficientit të jetë 20% , rritje kjo e cila, në të kundërtën, do të ndikonte negativisht në dendësinë e popullsisë dhe se aplikimi i kësja forme të kompensimit do të kishte efekt pozitiv në zbatimin racional të planeve rregulluese të miratuara. Efekti tjeter pozitiv për interesin e komunës gjatë aplikimit të kësaj forme të kompensimit do të ishte se komuna do të bahet pronare e këtyre pjesëve të tokave pa nevojën e pagesës së mjeteve financiare. Andaj duke u bazuar në të thënët e përmendura më lartë, dhe duke u bazuar në praktikën e komunave tjera (Prishtina, Ferizaj, Fushë Kosovës etj) rezulton se aplikimi i kësaj forme të kompensimit është i interesit të shumëfishtë për komunën, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.



Shtojca:

Shfrytëzueshmëria e parcelës është maximum 65% dhe etazhitetit maximal deri në P+5.

Nëse parcela kadastrale ka 500m^2 dhe pjesa e shpronësimit është 100m^2 do të kemi:

$$500 \times 0.65 = 325\text{m}^2$$

Për B+S+P+5=>

$$\text{Për P+5} => 325 \times 6 = 1950\text{m}^2$$

$$S=325\text{m}^2$$

$$B=325\text{m}^2$$

Pra 2600 m^2 sipërfaqe e lejuar për ndërtim.

Kompenzimi:

Sipërfaqja për kompenzim:

$$100\text{m}^2$$

$$100/500=0.2$$

$$\text{Për P+5} => 0.2 \times 1950 = 390\text{m}^2$$

$$\text{Për suteren} = (325 \times 0.2) \times 0.5 = 32.5$$

$$\text{Për bodrum} = 0.00$$

Totali i m^2 shtesë i cili do të shndërrohet në etazhat e mësipërme:

$$390 + 32.5 = 422.5\text{m}^2$$



01.Nr 105/02-29574/21

Datë: 28.09.2021

Në mbështetje të nenit 58, pika b dhe c, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 73 paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 4 paragrafi 1 i Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HAPJEN E KUTIVE TË ANKESAVE

1. Me anë të këtij vendimi formohet komisioni për hapjen e kutive të ankesave të qytetarëve të cilat janë të vendosura në hyrje të objektit.
2. Bazuar si në pikën 1 të këtij vendimi, komisioni do të përbëhet nga:
 - a. Besnik Dema;
 - b. Fatlume Selimi;
 - c. _____ (nga shoqëria civile).
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit si dhe procedurat e hapjes së kutive të ankesave janë të përcaktuar me nenin 5 dhe 7 të Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave, andaj komisioni është i obliguar t'i aplikojë këto rregulla.
4. Komisioni ka mandat një vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Ofrimi i shërbimeve ndaj qytetarëve si dhe implementimi i politikave publike që shkojnë në favor të qytetarëve është synimi kryesor i yni. Duke ditur natyrën e llojiljojshme të ankesave si dhe ruajtjen e privatësisë së qytetarëve tanë, kemi vendosur që në hyrjen kryesore të objektit komunal të vendosen kutitë e ankesave. Rrjedhimisht me qëllim të dëgjimit të zërit dhe dërgimin e ankesave apo sugjerimeve të qytetarëve në vendin e duhur, formohet ky komision konform Rregullores 02/2016 për Hapjen e Kutive të Ankesave.

I dërgohet:

Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme;

Anëtarëve të Komisionit;

Arkivit të Komunës.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	24.09.21	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri		Shfojtë	

01

400109-29570-1



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Në bazë të nenit 13.17 të Ligjit nr.03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 61.dhe 73, të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Marrëveshjes së Mirekuptimit 01.104/02-27758 të datës 08.09.2021 mes Kryetarit te Komunes dhe Shoqates për personat me aftesi te kufizuara Handikos-Kaçanik, Memorandum Mirëkuptimit mes Shoqates për personat me aftesi te kufizuara Handikos-Kaçanik dhe Shoqatës Humanitare KIF Liria nga qyteti Vaxjo-Suedi e dates 09.09.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

I

Përmes ketij vendimi, Kryetari i komunes se Kaçanikut, ndanë mjete financiare ne shume prej 4,000.00 euro (katër mijë euro) Shoqates për personat me aftesi te kufizuara Handikos-Kaçanik, në emër të shpenzimeve të transportit për sjelljen e një donacioni me mjete ndihmëse – paisje dhe material shpenzues për nevoja të QKMF-së ne Kaçanik.

II

Mjetet nga Neni 1 i ketij vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunes se Kaçanikut per vitin 2021 nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve, të cilat transferohen ne llogarinë aktive bankare të Shoqates për personat me aftesi te kufizuara Handikos-Kaçanik.

III

Për zbatimin e ketij Vendimi do te kujdeset drejtoria e Ekonomise, Financave dhe Zhvillimit ne Kaçanik.

IV

Ky vendim hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit te Komunes së Kaçanikut.

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Financave, dhe Shoqata për personat me aftesi te kufizuara Handikos -Kaçanik.

Më: 23.09.2021

KRYETARI I KOMUNËS SË KAÇANIKUT

